



Prishtinë: 27.11.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1206\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1986\_09\_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **25.10.2019**.

### në seancën e mbajtur më datë 27.11.2019, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.D. nga fshati Bardhosh, Prishtinë, me shifër të konsumatorit DPR – 90032004 si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1986\_09\_19 i datës 24.09.2019

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 25.10.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: shpenzimi i energjisë elektrike dhe faturimi i bërë nga KESCO për periudhën 05/2017 dhe 06/2017 janë reale të sakta. KESCO në ankesë ka theksuar se punëtorët e autorizuar të KEDS në procesverbalin nr.057437 të datës 13.09.2017 ka theksuar se pika matëse është në rregull por në ormanin shpërndarës është një fazë e cila ka pasur shkarkim në tokë. KESCO në ankesën e tyre kanë potencuar se sipas Kodit të Matjes pika 3, dhe 3.1.1 theksohet se pika matëse është pika ku bëhet matje e shkëmbimit të energjisë elektrike në mes të sistemit të shpërndarjes dhe transmisionit, gjeneratorëve, konsumatorëve dhe përdoruesve tjerë. Gjithashtu kanë theksuar se sipas nenit 3.5.2 mirëmbajtja e njehsorit është përgjegjësi e OSSH dhe se konsumatori është përgjegjës për sigurinë e njehsorit të instaluar në pronën e tij dhe se është përgjegjës për instalimin e brendshëm. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1986\_09\_19 të datës 24.09.2019 për konsumatorin A.D. me shifër DPR – 90032004.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se shpenzimi i energjisë elektrike dhe faturimi i bërë nga KESCO për periudhën 05/2017 dhe 06/2017 janë reale të sakta, Bordi i ZRRE-së thekson se nga Raporti mbi kontrollimin- pranimin e grupit matës nr. 0057437 i datës 13.09.2017 vërtetohet nga vet punëtorët e autorizuar të KEDS-it se te konsumatori në fjalë në ormanin shpërndarës njëra fazë ka pas shkarkim në tokë. Fakti tjetër që tregon se shpenzimet e muajit 05/2017 dhe 06/2017 nuk paraqesin shpenzim real mujor është edhe krahasimi i shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e më hershme dhe te më vonshme vërteton se konsumatori ne këtë periudhe kontestuese ka pasur shpenzim me të lartë dhe se ky shpenzim nuk paraqet shpenzim real te konsumatorit.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se sipas Kodit të Matjes pika 3, dhe 3.1.1 ku theksohet se pika matëse është pika ku bëhet matje e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe pikës 3.5.2 mirëmbajtja e njehsorit është përgjegjësi e OSSH dhe se konsumatori është përgjegjës për sigurinë e njehsorit të instaluar në pronën e tij dhe se është përgjegjës për instalimin e brendshëm, Bordi i ZRRE thekson se nuk janë fare kontestuese këto dispozita ligjore pasi Kodin e Matjes të OSSH e ka aprovuar Bordi i ZRRE dhe është i shumë i vetëdijshëm mbi bazën ligjore. Duhet theksuar se pika matëse është kufiri teknik dhe komercial mes konsumatorit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe se për mirëmbajtjen e pikës matëse është OSSH dhe se konsumatori është përgjegjës për instalimin e brendshëm. Bordi i ZRRE-së thekson se para se të bëhet ky konstatim se në ormanin shpërndarës njëra fazë ka pas shkarkim në tokë, punëtorët e autorizuar të KEDS me datë 22.02.2017 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe kanë theksuar se që vendoset njehsori i mençur (smart) në TS. Pra është vet KEDS që ka bërë ndërrimin e pikës matëse te konsumatori në fjalë me datë 22.02.2017 dhe se me datë 13.09.2017 është bërë konstatimi kur është theksuar se në ormanin shpërndarës njëra fazë ka pas shkarkim në tokë, dhe se edhe shpenzimi i konsumatorit të energjisë elektrike në këtë periudhe kontestuese është më i lartë se periudhat tjera para dhe pas periudhës kontestuese.

Bordi i ZRRE ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit në fjalë dhe ka vërejtur se shpenzimi i konsumatorit të energjisë elektrike në këtë periudhe kontestuese është më i lartë se periudhat tjera para dhe pas periudhës kontestuese. Bordi i ZRRE-së thekson se sipas rrjedhës se energjisë elektrike shpenzimi i konsumatorit për periudhat e me hershme të njëjta me njehsorin elektrik nr.64674463 ka qenë: për periudhën 05/2015 është 351 kWh, për periudhën 06/2015 është 437 kWh, për periudhën 05/2016 është 271 kWh, për periudhën 06/2016 është 301 kWh, kurse me njehsorin e ri nr.32631262 për periudhën 05/2018 është 772 kWh, periudhën 06/2018 është 464 kWh, periudhën 05/2019 është 1,121 kWh, si dhe periudhën 06/2019 është 566 kWh. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së thekson se duke pasur parasysh të gjitha shkresat e lëndërs konstaton se se fatura mujore e energjisë elektrike për periudhën maj 2017 me shpenzim 5,535 kWh si dhe fatura mujore e energjisë elektrike për periudhën qershor 2017 me shpenzim 7,910 kWh nuk paraqesin shpenzim real te konsumatorit dhe se vendimi i organit të shkallës së parë për të shkaruar faturat 05/2017 dhe 06/2017 dhe se për këto periudha bazuar ne shpenzimet e periudhës 05/2018 dhe 06/2018 është vendim i drejtë, i bazuar në fakte konkrete dhe i ligjshëm.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A.D. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.